



Nr. 219 Prot.

Tiranë, më 21 / 1 / 2022

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

PËR

NDARJEN E SHOQËRISË "HEKURUDHA SHQIPTARE"

SHOQËRISË "HEKURUDHA SHQIPTARE" DURRËS

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 90, datë 1.7.2021 "Për ndarjen e shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" sht Durrës dhe statutit të shoqërisë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" sht Durrës ;


VENDOSA:

1. Ndarjen e shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" sht Durrës në katër shoqëri pritëse si më poshtë:
 - Shoqëria Aksionare për Infrastrukturën Hekurudhore, në vijim Administruesi i Infrastrukturës;
 - Shoqëria Aksionare për Transportin e Udhëtarëve, në vijim Sipërmarrësi Hekurudhor i Transportit të Udhëtarëve;
 - Shoqëria Aksionare Hekurudhore për Transportin e Mallrave, në vijim Sipërmarrësi Hekurudhor Transportit të Mallit;
 - Shoqëria Aksionare Hekurudhore për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse, në vijim Sipërmarrësi i Mirëmbajtjes së Mjeteve Hekurudhore.
2. Kalimi të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë që ndahet, tek shoqëritë pritëse. Raporti i ndarjes të përgatitet nga grupi i audituesëve ligjor si më poshtë:
 - Kreston Albania shpk
 - Public Accounting Service, Union and Trust;
 - RSM Albania shpk;
 - Z. Avni Tobli;
 - Zrj. Anita Pllaj;
 - Zrj. Eljona Hoxha;
 - Zrj. Aida Maloku.
3. Ndarja e shoqërive të kryhet konform neni 216 deri në 225 të Ligjit Nr. 9901, date 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar.
4. Drejtuesit e shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" sht Durrës, së bashku me Këshillin Mbikëqyrës, të përcaktojnë planin social që përcaktor rregullat, se cilët nga punonjësit do të largohen nga puna për shkak të riorganizimit të shoqërive dhe cilët do të jenë të punësuar. Ky plan do të miratohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Plani social do të jetë pjesë e marrëveshjes së ndarjes që do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



5. Raporti i Ekspertëve dhe Marrëveshja e ndarjes do të dërgohen për miratim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
6. Pas përfundimit, shoqëria "Hekurudha Shqiptare" sh.a. Durrës vlerësohet e prishur dhe çregjistrohet nga QKB pa kryerjen e procedurës së likuidimit.
7. Procedura e ndarjes të përfundojë brenda muajit Shkurt 2022.
8. Ngarkohet shoqëria "Hekurudha Shqiptare" për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 1219/Prot.
2

Tiranë, më 22.5.2022

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 102 Datë 22.5 /2022

FPZ/
26.7.2022

PËR

**NJË NDRYSHIM NË PIKËN 2 TË VENDIMIT NR. 1219 PROT. DATË 21.01.2022
“PËR NDARJEN E SHOQËRISË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA DURRËS”.**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjit nr.90 datë 01.07.2021 “Për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sha Durrës” dhe statutit të shoqërisë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sha Durrës;

VENDOSA:

1. Në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sha Durrës nr. 1219 prot. datë 21.01.2022, pika 2 ndryshohet si më poshtë:
 - Raporti i ndarjes së shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sha të përgatitet nga grupi i ekspertëve si më poshtë:
 - Z. Sokol Toska
 - Znj. Aida Maloku
 - Znj. Vullnetare Çela
2. Ekspertëve t’iu komunikohen detyrat e përcaktuara në Vendimin nr. 1219 prot. datë 21.01.2022.
3. Ngarkohet shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sha Durrës për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Delina IBRAHIMAJ